

KONTAKT SH.P.K.

**Raporti i Auditimit
Dhe Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

Tiranë 29 Mars 2022

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Ortakëve të shoqërisë KONTAKT Sh.p.k.,

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KONTAKT Sh.p.k., bashkëlidhur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 si dhe performancën e saj dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Informacionet e tjera përfshijnë informacione që përfshihen në Raportin e Përgjithshëm të Shoqërisë, por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe në raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti i Përgjithshëm i Shoqërisë parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë konkluzion që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart, kur ato na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit, ose nëse duket se ato përmbajnë anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali material, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.


Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.
- Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveçse çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Tiranë më datë, 29 Mars 2022

UHY Elite sh.p.k
Auditues Ligjorë

Arton Jolea
Jolea



UHY Elite
Auditing, Tax & Consulting

NIPT: K 31712103 L
Tirana - Albania

Kontakt sh.p.k

Përmbajta

	<u>Faqe</u>
Pasqyra e Pozicionit Financiar më datë 31 Dhjetor 2021	3
Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	4
Pasqyra e ndryshimit të kapitaleve të veta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	5
Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021	6
Shënime për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021	7-25





Pasqyra e Pozicionit Financiar më datën 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

		31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
AKTIVE			
Mjete monetare	6	68,241,545	61,663,763
Aktive afatshkurtër			
Llogari të arkëtueshme	7	7,025,704	46,945,372
Llogari të tjera të arkëtueshme	8	161,147,253	119,797,560
		168,172,957	166,742,932
Inventari			
Lëndë e parë	9	87,648,423	35,891,913
Prodhim në proces	9	4,032,241,101	1,719,632,491
Produkt i gatshëm	9	1,843,347,681	1,157,578,548
Parapagesat për furnizime	9	49,332,802	16,945,764
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	9	761,452,585	1,195,922,085
		6,774,022,592	4,125,970,801
Aktive afat gjatë			
Aktive afat gjatë materiale	10	128,677,320	145,360,907
Aktive afat gjatë materiale të investuara	10	1,584,736	134,316,953
Truall	10	5,068,789	4,743,041
Aktive afatgjatë jo materiale	10	116,269	255,457
		135,447,114	284,676,358
		7,145,884,207	4,639,053,854
DETYRIME			
Detyrime afatshkurtër			
Llogari të pagueshme (furnitorë)	11	222,282,637	73,537,654
Detyrime ndaj organeve tatimore	12	13,143,379	14,898,052
Të tjera detyrime afatshkurtër	13	532,465,497	468,096,023
Parapagime të arkëtuara	14	5,433,578,039	3,111,425,144
		6,201,469,552	3,667,956,873
Detyrime afat gjatë			
Grante dhe të ardhura të shtyra	15	216,281	1,082,622
		216,281	1,082,622
KAPITALET E VETA			
Kapitali	16	659,221,542	659,221,542
Rezerva ligjore	16	1,253,178	1,253,178
Fitime të paspërndara	16	132,106,117	132,106,117
Fitime/(Humbje) e vitit financiar	16	151,617,537	177,433,522
		944,198,375	970,014,359
		7,145,884,207	4,639,053,854

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 7-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtuesit e Kontakt sh.p.k më datë 22 Mars 2022 dhe janë firmosur nga:

Dipl. Ing. Fatmir Bektashi
Administrator

Eralda Ikonomi
KM Eralda Ikonomi
Konsulent Financiar

Fatmir Bektashi



Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në 31.12.2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifkohet monedha tjetër)

		<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Të ardhurat			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	850,442,514	1,382,625,786
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	152,911,322	22,027,176
Ndryshim në punë në proces	17	1,843,642,712	2,128,691,854
Ndryshim në inventar produkt i gatshëm	17	685,769,132	(945,104,074)
		<u>3,532,765,681</u>	<u>2,588,240,742</u>
Shpenzimet për aktivitetin kryesor			
Mallra, lënda e parë dhe shërbime	18	(800,176,679)	(611,876,945)
Punime ndërtimi	18	(1,287,487,764)	(725,554,416)
Shpenzime personeli	19	(294,941,075)	(249,457,268)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	20	(1,041,715,235)	(703,464,338)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	10	(35,017,797)	(37,594,197)
		<u>(3,459,338,549)</u>	<u>(2,327,947,164)</u>
Fitimi (Humbja) nga aktiviteti kryesor		<u>73,427,131</u>	<u>260,293,578</u>
Të ardhurat dhe (shpenzimet) financiare	21	107,129,034	(49,700,329)
		<u>107,129,034</u>	<u>(49,700,329)</u>
Fitimi përpara tatimit		<u>180,556,165</u>	<u>210,593,249</u>
Shpenzime të panjohura		12,368,021	10,471,591
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(28,938,628)	(33,159,727)
Fitimi neto i vitit		<u>151,617,537</u>	<u>177,433,522</u>
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE			
Fitimi neto i vitit		<u>151,617,537</u>	<u>177,433,522</u>
Diferenca konvertimi nga operacionet jashtë njësisë		-	-
Rivlerësime të pasurive të paluajtshme		-	-
Tatim mbi të ardhurat gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën		<u>151,617,537</u>	<u>177,433,522</u>

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 7-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Pasqyra e ndryshimeve në kapitalat e veta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rasteve kur specifikohet monedha tjetër)

	Kapital	Rezerva Ligjore	Fitimi i pashpërndarë	Rezultati i vitit	Totali
Balanca në 31 Dhjetor 2019	659,221,542	1,253,178	159,174,214	68,179,800	887,828,734
Fitim për vitin 2020	0	0	0	177,433,522	177,433,522
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	0	0	0	0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	0	0	0	177,433,522	177,433,522
Kontribute / shpërndarje tek aksionaret	0	0	0	0	0
Dividend të paguar aksionarëve	0	0	(27,068,097)	(68,179,800)	(95,247,897)
Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave	0	0	0	0	0
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes për aksionaret	0	0	(27,068,097)	(68,179,800)	(95,247,897)
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit	0	0	0	0	0
Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve	0	0	0	0	0
Totali i transaksioneve me aksionaret	0	0	0	0	0
Balanca ne 31 Dhjetor 2020	659,221,542	1,253,178	132,106,117	177,433,522	970,014,359
Fitim për vitin 2021	0	0	0	151,617,537	151,617,537
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	0	0	0	0	0
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	0	0	0	151,617,537	151,617,537
Kontribute / shpërndarje tek aksionaret	0	0	0	0	0
Dividend të paguar aksionarëve	0	0	0	(177,433,522)	(177,433,522)
Krijimi dhe (përdorimi) i rezervave	0	0	0	0	0
Totali i kontributeve dhe shpërndarjes për aksionaret	0	0	0	(177,433,522)	(177,433,522)
Ndryshime në zotërimet e degëve që nuk sjellin humbjen e kontrollit	0	0	0	0	0
Totali i ndryshimeve në zotërimin e aksioneve	0	0	0	0	0
Totali i transaksioneve me aksionaret	0	0	0	0	0
Balanca ne 31 Dhjetor 2021	659,221,542	1,253,178	132,106,117	151,617,537	944,198,375

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalat e veta duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 7-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifkohet monedha tjetër)

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Mjete monetare nga aktiviteti kryesor		
Fitimi nga aktiviteti kryesor	<u>180,556,165</u>	<u>210,593,248</u>
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizim	35,017,797	37,594,197
Shpenzime per tatim fitimin	2,611,838	2,870,321
Fitim/Humbje nga shitja e AAM	(5,437,772)	(2,171,299)
Të ardhura nga investime	-	-
Shpenzime të maturuara	-	-
Fitim/Humbje nga rivlerësimi	-	-
<i>Ndryshime në kapitalin qarkullues:</i>		
Rënie (rritje) në llogari te arkëtueshme	(1,430,026)	28,038,323
Rritje në inventarë	(2,648,051,790)	(1,497,825,475)
Rritje në llogari të pagueshme	2,533,512,679	1,933,935,155
<i>Rregullime të kapitalit qarkullues:</i>		
Tatimi fitimi i paguar	(31,550,466)	(36,030,044)
Mjete monetare nga aktiviteti kryesor	<u>65,228,424</u>	<u>677,004,427</u>
Aktiviteti investues		
Blerje aktive afatgjatë materiale	(28,957,670)	(56,863,705)
Shitja e aktiveve afatgjatë materiale	148,606,888	6,870,878
Mjete monetare nga aktiviteti investues	<u>119,649,218</u>	<u>(49,992,827)</u>
Aktiviteti financues		
Veprimtari financiare	(866,341)	(519,051,893)
Dividend i paguar	(177,433,522)	(95,247,897)
Mjete monetare nga aktiviteti financues	<u>(178,299,863)</u>	<u>(614,299,790)</u>
Rritje (rënie) neto në mjete monetare	<u>6,577,780</u>	<u>12,711,810</u>
Mjete monetare në fillim të periudhës	<u>61,663,764</u>	<u>48,951,953</u>
Mjete monetare në fund të periudhës	<u>68,241,543</u>	<u>61,663,763</u>

Pasqyra e rrjedhjes së parasë duhet lexuar në lidhje me shënimet shpjeguese në faqet 9-25 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

1. TË PËRGJITHSHME

Kontakt sh.p.k është themeluar më 07 Qershor 1999 në Tiranë, me objekt në fushën e ndërtimit, punime ndërtimi, projektme, prodhim materiale ndërtimi, mbikëqyrje, kolaudim, etj. Kontakt sh.p.k është regjistruar në QKB më 21 Dhjetor 2000, me NIPT: J92108006V dhe adresa e selisë është Rruga "Rr. Pasho Hysa Nr 26-0714 AL-1004 Tiranë". Kontakt sh.p.k drejtohet nga administratori, Z. Fatmir Bektashi, i cili është gjithashtu ortaku i vetëm i shoqërisë. Gjatë vitit 2021 shoqëria ka patur 176 të punësuar.

2. BAZA E KONTABILITETIT

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.1 Vijueshmëria

Drejtesit e shoqërisë kanë bërë një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vijueshmërinë e aktivitetit duke marrë parasysh të gjithë faktorët e theksuar më lart dhe janë të kënaqur që shoqëria ka burime për të vazhduar aktivitetin për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, drejtuesit nuk janë në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të mëdha mbi vijueshmërinë e shoqërisë. Prandaj, Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike, përjashtuar derivativët financiar (n.q.s ka), instrumentat financiarë me vlerë të drejtë përmes fitimit e humbjes dhe aktivet financiare të vlefshme për shitje, të cilat maten me vlerë të drejtë (n.q.s ka).

2.3 Monedha raportuese dhe funksionale

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK ("Lekë"), e cila është monedha raportuese dhe funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur.

Në veçanti, informacionet në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e kontabilitetit të natyrës së veprimeve që kryen Shoqëria.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdon)

Drejtimi i përgatit këto pasqyra financiare në bazë të vazhdueshmërisë. Në bërjen e këtij gjykimi, drejtimi konsideron pozitën financiare të shoqërisë, synimet e tanishme, rentabilitetin e operacioneve dhe qasjen në burimet financiare.

Drejtimi merr në konsideratë vlerësimet e kontabilitetit dhe një supozim të diskutuar më poshtë si vlerësime kritike kontabël dhe, në përputhje me rrethanat dhe jep një shpjegim përkatës

(a) Rishikimi i rënies në vlerë

Rikuperimi i aktiveve është një fushë që përfshin gjykimet e drejtimit, duke kërkuar vlerësimin nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën aktuale neto të rrjedhës së ardhshme të parasë që rrjedhin nga aktive të tilla, duke përdorur parashikimet e rrjedhës së parasë të skontuar me një normë të përshtatshme.

Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të rrjedhës së ardhshme të parasë, supozime të caktuara kërkojnë të bëhen në lidhje me çështje të pasigurta të cituara më poshtë.

SNRF kërkojnë nga Drejtimi që të ndërmarrë teste vjetore për rënien në vlerë të aktiveve me jetë të papërcaktuar dhe aktiveve me jetë të përcaktuar, nëse ngjarjet apo ndryshimet e rrethanave tregojnë se vlera kontabël e aktivitetit mund të mos rikuperohet.

Drejtimi i Shoqërisë synon të rishikojë aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale të paktën një herë në vit për të përcaktuar nëse një rishikim i plotë për rënien në vlerë është i nevojshëm.

(b) Matja e vlerës së drejtë

Një numër i politikave dhe gjykimeve të kontabilitetit të Shoqërisë kërkojnë matjen e vlerave të drejta, si për pasuritë dhe detyrimet financiare dhe jo financiarë. Shoqëria ka angazhuar vlerësues të pavarur për të përcaktuar matje të rëndësishme të vlerës së drejtë, duke vlerësuar provat e marra nga palët e treta për të mbështetur konkluzionin se vlerësimet e tilla përmbushin kërkesat e SNRF. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të zgjedhur një shumëllojshmëri metodash dhe të bëjë supozime që bazohen kryesisht në kushtet e tregut që ekzistojnë në çdo datë raportimi. Shoqëria përdor analizën e skontuar të fluksit të mjeteve monetare për aktivet dhe detyrimet financiare të cilat nuk janë tregtuar në tregjet aktive. Gjatë matjes së vlerës së drejtë të një aktivi ose detyrimi, Shoqëria përdor të dhëna të tregut të vëzhgueshëm sa më shumë që të jetë e mundur.

(c) Tatim fitimi

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Përcaktimi i vlerës së tatimit mbi fitimin e shtyrë kërkon gjykime të rëndësishme. Ekzistojnë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi aktual tatimor është i pasigurtë. Kur rezultati përfundimtar tatimor i këtyre çështjeve ndryshon nga shuma fillestare e regjistruar, ndryshime të tilla ndikojnë në aktivet dhe detyrimet për tatim fitimin e shtyrë në periudhën në të cilën është bërë përcaktimi.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë do të aplikohen në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat.

a) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë konvertuar në pasqyrën e pozicionit financiar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga konvertimi, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit për monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, sipas Bankës së Shqipërisë, kanë qenë respektivisht si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
USD	106.54	100.84
EUR	120.76	123.70

b) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Shoqërisë përbëhen nga instrumentet joderivative: paraja dhe ekuivalentet e saj, llogari të arkëtueshme, detyrime të tjera të pagueshme. Shoqëria nuk zotëron instrumente financiare me vlerë tregu ose të mbajtura për shitje.

Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk kanë vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen, përveç siç përshkruhet më poshtë. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset e mjeteve monetare nga aktivitet financiare mbarojnë ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa mbajtur kontrollin ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare llogariten në datën kur Shoqëria zotëron blerjen ose shitjen e aktivitet. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë përfundojnë ose shkarkohen ose anulohen.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Aktivitet e tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni të drejtpërdrejtë që i atribuohet. Pas njohjes fillestare, tregtia dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paratë në dorë dhe llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat e pakufizuara që janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur parash dhe janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë.

Të tregtueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet e tjera fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar.

c) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Ndërtesa, makineritë e pajisjet maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Të gjitha aktivet afat gjatë janë pasqyruar me koston e blerjes. Kosto e blerjes përfshin shpenzimet e lidhura drejt për drejt me blerjen e aktivit.

Kur pjesë përbërëse të aktivit kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato mbahen si zëra të vecantë të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një elementi të aktivit afatgjatë material përcaktohen nga krahasimi i të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbartur të aktivit, dhe paraqiten neto në seksionin e të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave shpenzimeve.

Shpenzimet të mëpasshme

Shpenzimet të mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me shpenzimet do të rrjedhin në Shoqëri.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet sipas metodës së vlerës së mbetur të aktivit në fund të çdo viti, e cila është kosto historike minus amortizimin e akumuluar. Në përputhje me SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, ndryshimet në jetën ekonomike të aktiveve trajtohen si ndryshime të hamendesive dhe zbatohen në mënyrë prospektive. Për vitin 2021, norma vjetore e amortizimit nuk ka ndryshuar.

Emërtimi	Metoda e amortizimit	Norma vjetore
Ndërtesa	Mbi vlerën e mbetur	5%
Makineri	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje zyre (mobilje)	Mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje Elektronike	Mbi vlerën e mbetur	25%

(d) Inventarët

Shoqëria ka vlerësuar gjendjet e inventarit në datën e mbylljes së bilancit duke përdorur metodën e më të voglës midis koston së blerjes dhe vlerës neto të realizueshme.



Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2021

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(e) Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit që ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të vlerësuara të aktivit financiar dhe që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivitetet financiare individuale të rëndësishme janë testuar për zhvlerësim në baza individuale. Aktivitetet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në Kompanitë që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës financiare. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ndryshimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasqyrën e performancës financiare

ii. Aktivet jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në secilën pasqyrë të pozicioneve financiare për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme të vlerësuara zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilat nuk janë llogaritur flukset monetare të ardhshme rregulluar. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës financiare.

(f) Të ardhurat

